ZYRA E DALJES-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. 020-241/16
Data 18.04.2019
-VI-

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| **Për:** | **Imri Ahmeti,** Kryetar i Komunës së Lipjanit<br>**Daut Azemi,** Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit | |
| **Cc:** | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| **Përmes:** | **Adijana Hodžić, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal**<br>**Rozafa Ukimeraj,** Sekretare e Përgjithshme | |
| **Nga:** | **Venera Cerkini,** Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave, MAPL | Datë: 12.04.2019<br>Nr.020-241 |
| **Lënda:** | Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë se aktit të Komunës së Lipjanit | |
| **Lloji i aktit:** | Vendim i Kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendimi 15Nr.463-14826, për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për varreza në fshatin Rubofc. |
| I miratuar më datë: 28.02.2019 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06.03.2019 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson së akti i komunës **<u>është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi</u>**.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

| Nr. | Formulimi në aktin e komunës | Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim |
|---|---|---|
| 1. | Vendimi 15Nr.463-14826, për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për varreza në fshatin Rubofc. | Vendimi 15Nr.463-14826, i Kuvendit të Komunës së Lipjanit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për varreza në fshatin Rubofc, nuk është në harmoni me Ligjin Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës përkatësisht nenit 10 pika 1.4 e këtij ligji ku sqaron se toka ipet ne shfrytëzim për bashkësitë fetare për zhvillim të aktiviteteve fetare e jo edhe për varreza.<br>Kuvendi i Komunës mund të merr vendim të caktoj lokacionin për varreza në fshatin Rubovc ashtu siç kërkohet nga bashkësia Islame por jo të ipet në shfrytëzim. |

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, kërkon nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës së Lipjanit që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-241/16
-VI-
Data Datum Date 18.04.2019

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Za: | Imri Ahmeti, gradonačelnik Opštine Lipljan<br>Daut Azemi, predseadvajući Skupštine opštine Lipljan | |
| Kopija: | Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u<br>Jedinici za administraciju dokumenata u opštini<br>Odeljenja za zakonska ppitanja i monitorisanje opština-MALS | |
| Preko: | Adriana Hodžić, ministar MALS-a,<br>Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a, | |
| Od: | Venera Çerkini v. d. rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS | Datum, 12.04.2019.<br>Br. 020/241 |
| Predmet: | Zahtev za reviziju akta opštine Lipljan | |
| Vrsta akta: | Odluka Skupštine opštine Lipljan | |

Poštovani gradonačelniče,
Poštovani predsedavajući

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

| |
|---|
| Odluka 15br.463-14826, za davanje na korišćenje opštinske imovine Savetu islamske zajednice u Lipljanu za groblja u selu Rubovce. |
| Usvojena dana, 28.02.2019. |
| Predložena na razmatranje u MALS-u, dana, 06.03.2019. |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je <u>opštinski akt u suprotnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.</u>

Neusaglašenost akta opštine predložena na razmatranje zakonitosti kao u nastavku:

| **Formulisanje u aktu opštine** | **Zakonska odredba sa kojom je akt opštine u suprotnosti.** |
|---|---|
| Odluka 15br.463-14826, za davanje na korišćenje opštinske imovine Savetu islamske zajednice u Lipljanu za groblja u selu Rubovce. | Odluka 15br.463-14826, Skupština opštine Lipljan za davanje na korišćenje opštinske imovine Savetu islamske zajednice u Lipljanu za groblja u selu Rubovce, nije u skladu sa Zakonom br.04/L-144 o davanju na korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine, odnosno članom 10 tačka 1.4 ovog zakona koji tumači da: opštinska imovina/zemljište se daje na korišćenje verskim zajednicama za razvijanje verskih aktivnosti ali ne i za groblja.<br>Skupština opštine može doneti odluku da odredi lokaciju za groblja u selu Rubovce, kao što se traži od Islamske zajednice ali ne i za korišćenje. |

Iz gore navedenog, Ministarstvo administracije lokalne samouoprave od Skupštine opštine i gradonačelnika opštine traži da preduzimaju konkretne mere kako bi akt opštine uskladile sa zakonskim odredbama na snazi, unutar predviđenog roka od 30 dana, od dana primanja akta za reviziju. Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za dalja tumačenja u vezi sa ovom procenom.

KRYESE-ULAZNA-INCOMING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data 06.03.2019
-01- 020-241

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIKA KOSOVA**
**REPUBLIC OF KOSOVO**

**KOMUNA E LIPJANIT**
**OPŠTINA LIPLJAN**
**MUNICIPALITY OF LIPJAN**

Në mbështetje të nenit 12,14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040,Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 10 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 22 nëntor 2012, nenit 20 paragrafi 3 pika 3.3 të Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, dhe nenit 9,17,20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 28. 02. 2019, pas shqyrtimit te propozim vendimit te Kryetarit te Komunës miratoi këtë:

# VENDIM
# PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE KËSHILLIT TË BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR VARREZA NË FSHATIN RUBOFC

## Neni 1

Me këtë vendim, ipet në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh pronat komunale, Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan, si në vijim:

1.Parcela kadastrale P-71409068-00756-0 në vendin e quajtur "Drum çeramdnica" me kulturë arë e kl.3-të me sipërfaqe prej 3517m$^2$ Zona kadastrale Rubofc, P.Sh. e Kuvendit Komunal Lipjan.

2. Parcela kadastrale P-71409068-00757-0 në vendin e quajtur "Drum" me kulturë jo Pjellore me sipërfaqe prej 4976 m$^2$ Zona kadastrale Rubofc, P.Sh. e Kuvendit Komunal Lipjan.

## Neni 2

Pronat komunale siç përcaktohet në nenin 1 të këtij Vendimi ipen në shfrytëzim me destinim për varreza në fshatin Rubofc dhe nuk mund të shfrytëzohen për qëllime tjera.

## Neni 3

Me këtë Vendim obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në lidhje me procedurën e regjistrimit, KK Lipjan shfrytëzues Këshilli i Bashkësisë Islame në Lipjan me destinim për varreza, siç përcaktohet në nenin 1 të këtij Vendimi.

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronësoro-juridik, Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati për Shërbime Publike.

**Neni 5**

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

**15Nr.** 463-14826
**Lipjan, më 04. 03. 2019**

**KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN**

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Daut Azemi**

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data / Datum / Date 06.03.2019
Njësia organizative: -01- | Nr. i Lëndës: 020 - | Shtojca: 241 | Vlera:

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

U skladu člana 12,14 Zakona o Lokalnom Samoupravljanju Br.03/L-040, Službeni list Repubike Kosova, br.28 datuma 4 juni 2008, član 10 stavka 1 tačka 1.4 Zakona o davanju na korišćenje i Razmenu opštinske nekretnine Br.04/L-144 Službeni List Republike Kosova datuma 22 novembar 2012, člana 20 stavka 3 tačka 3.3 Pravilnika VRK Br. 23/2013 o određivanju procedura davanju na korišćenje i razmenu nepokretne opštinske imovine, i člana 9,17,20 Statuta Opštine Lipljan 1Br.110-623 dt. 26.09.2008, Skupština Opštine na sednici održanoj dana 28.02.2019, nakon razmatranja predlog odluke Presednik Opštine usvojio je sledeće:

## ODLUKA
## O DAVANJU NA KORIŠĆENJE OPŠTINSKE IMOVINE ISLAMSKOJ ZAJEDNICI U LIPLJANU ZA GROBLJA U SELU RABOVCE

### Član 1

Ovom Odlukom, daje se na dugoročno korišćenje od 99 godina opštinska imovina, Islamskoj Zajednici u Lipljanu kao sledeće:

1. Katastarska parcela P-71409068-00756-0 na mesto zvano „Drum ćeremidnica“ sa kulturom njiva 3-klase sa površinom od 3517 $m^2$ katastarska zona Rabovce, DI Skupštine Opštine Lipljan.
2.Katastarska parcela P-71409068-00757-0 na mesto zvano „Drum“ sa kulturom neplodna sa površinom od 4976 $m^2$ katastarska zona Rabovce, DI Skupština Opštine Lipljan.

### Član 2

Opštinske Imovine kao što su navedene u članu 1 ove Odluke daje se na korišćenje za destiniranje seoskog groblja u Rabovce i ne može se koristiti za druge ciljeve.

### Član 3

Sa ovom Odlukom obavezuje se Direktorat za Geodeziju i Katastar da preduzme sva potrebna delovanja u vezi sa procedurom registrovanja, SO Lipljan korisnik Odbor Islamske Zajednice u Lipljanu sa destinacijom za groblja kao što je određeno u članu 1 ove Odluke

**Član 4**

O sprovođenju ove Odluke staraće se kancelarija Predsednika-Imovinsko- pravni sektor, Direktorat za Urbanizam, Planiranje i Zaštitu Sredine, Direktorat za Geodeziju i Katastar i Direktorat za Javne Usluge.

**Član5**

Ova Odluka stupa na snagu 7 dana nakon objavljivanja na web staranici Opštine.

**15Br.** 463 - 14826
**Lipljan,dana 04.03.2019**

**SKUPŠTINA OPŠTINE LIPLJAN**

**Predsedavajući Skupštine**
**Daut Azemi**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 40 shkronja (h) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që:

Në mbështetje të nenit 12,14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040,Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 10 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 22 nëntor 2012, nenit 20 paragrafi 3 pika 3.3 të Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, dhe nenit 9,17,20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me datë ______2019 të miratojë këtë:

PROPOZIM

## VENDIM
## PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE KËSHILLIT TË BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR VARREZA NË FSHATIN RUBOFC

### Neni 1

Me këtë vendim, ipet në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh pronat komunale, Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan, si në vijim:

1.Parcela kadastrale P-71409068-00756-0 në vendin e quajtur "Drum çeramdnica" me kulturë arë e kl.3-të me sipërfaqe prej 3517m$^2$ Zona kadastrale Rubofc, P.Sh. e Kuvendit Komunal Lipjan.

2. Parcela kadastrale P-71409068-00757-0 në vendin e quajtur "Drum" me kulturë jo Pjellore me sipërfaqe prej 4976 m$^2$ Zona kadastrale Rubofc, P.Sh. e Kuvendit Komunal Lipjan.

### Neni 2

Pronat komunale siç përcaktohet në nenin 1 të këtij Vendimi ipen në shfrytëzim me destinim për varreza në fshatin Rubofc dhe nuk mund të shfrytëzohen për qëllime tjera.

Neni 3

Me këtë Vendim obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në lidhje me procedurën e regjistrimit, KK Lipjan shfrytëzues Këshilli i Bashkësisë Islame në Lipjan me destinim për varreza, siç përcaktohet në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronësoro-juridik, Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati për Shërbime Publike.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Arsyetim

Këshilli i Bashkësisë Islame në Lipjan me Nr.151/18 dt.19.11.2018, në emër të banorëve të fshatit Rubofc i Madh me datë 19.11.2018 ka parashtruar kërkesën 1-463-70282 pranë zyrës së Kryetarit të Komunës-Sektorit pronësoro-juridik, përmes së cilës kanë kërkuar caktimin e një parcele komunale me sipërfaqe prej 35 ari për varreza që do të shërbejë për të gjithë banoret e fshatit.

Pas shqyrtimit të kërkesës së cekur më lartë dhe të gjendjes faktike në terren me datë 08.02.2019 nga zyrtarët e sek.pronësoro-juridik dhe gjeodetit është verifikuar se parcela kadastrale P-71409068-00756-0 në vendin e quajtur "Drum çeramdnica" me kulturë arë e kl.3-të me sipërfaqe prej 3517m$^2$ është e lirë dhe e njëjta kërkohet nga KBI-ja të ipet në shfrytzim me destinim për varreza në fshatin Rubofc, ndërsa parcela kadastrale P-71409068-00757-0 në vendin e quajtur "Drum" me kulturë jo Pjellore me sipërfaqe prej 4976 m$^2$ është në kufij me parcelën 756 dhe sipas gjendjes faktike në terren ekzistojnë varrezat aktuale me çka dëshmohet edhe me fotot që janë bërë dhe njëjta parcelë nr.757 të ipet në shfrytëzim KBI-së, siç përcaktohet në nenin 1 të këtij propozim-Vendimi.

Prandaj duke marr parasysh arsyet e cekura më lartë, në pajtim me dispozitat të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 28 e dt. 4 qershor 2008, Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 22 nëntor 2012 dhe të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, kërkojmë nga kuvendi komunal miratimin e këtij propozim-Vendimi.

Shtojcë:
- Kërkesa 1-463-70282 dt. 19.11.2018
- Certifikatat e pronësisë-Kopje nga plani, orto-foto

1Nr. 463 - 9505

Lipjan, më 12-02 2019

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës
**KËSHILLI I BASHKËSISË ISLAME LIPJAN**

Nr: 151/18
Datë: 19/11/2018
LIPJAN

KËSHILLI I BASHKËSISË ISLAME COUNCIL OF ISLAMIC COMMUNITY
1956
LIPJAN

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

| | | |
|---|---|---|
| Pranuar me' / Primljeno: 19-11-2018 | | |
| Njësia / Jedinica | Numri / Broj | Shtojca / Dodatak |
| 1-463 | 70282 | |

Zyrës së Kryetarit te Komunës Z.Imri Ahmeti

Sektorit Pronësoro –Juridik

K E R K E S Ë

Këshilli i Bashkësisë Islame në Lipjan, në emer te fshatit Rubovci I Madh ... Lipjanit, kërkon nga sektori pronësoro-juridik të Komunës së Lipjanit ndarjen e një parcele në Rubovci I Madh për Varreza të fshatit në siperfaqe prej 35 ari ne ngastren Kadast... Nr.00756-0 ZK Rubovci I Madh, prone Komunale dhe do te sherbejë për Varreza ...

Fshati Rubovci I Madh janë përcaktuar në këtë parcelle te larteshenu... Varreza e jo për diqka tjeter..

Shpresojmë se kërkesa e jonë do të realizohet.

Me nderime te sinqerta.

Lipjan KRYE...

19.11.2018

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA
Bashkësia Islame e Kosovës
KËSHILLI I BASHKËSISË ISLAME COUNCIL OF ISLAMIC COMMUNITY

Adresa: Këshilli i Bashkësisë Islame
Lipjan
Tel: 038/ 581 357 E-mail. kbilipjan@hotmail.com

**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71409068-00756-0

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 356/19 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 07.02.2019 - 10:51 |
| Komuna / Opština / Municipality: | Lipjan / Lipljan / Lipjan |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | RUBOFC / RABOVCE / RUBOVC |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | Lipjan / Lipljan / Lipjan |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-71409068-00756-0 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | | 3517 | 0014-85 | | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendbanimi - adresa<br>Prebivaliste - adresa<br>Resident - address | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address Details | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| DRUM QERAMIDNICA/DRUM QERAMIDNICA/DRUM QERAMIDNICA | | DRUM QERAMIDNICA | | |

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Arat/Njive/Arable | Arë E Klasës 3/Njiva 3 Klase/3rd Class Arable Land | 3517 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor | P.SH. E KUVENDIT KOMUNAL LIPJAN | KCID1411956 | RUBOVCË / RUBOVCË / RUBOVCË / | | LIPLJAN | 1/1 | 0014-85 | |

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : LIPJAN

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Rubofc

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m2 |
|---|---|---|
| P-71409068-00756-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 3517,0 |
| | | |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:1000

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 07.02.2019

Koha/ Vreme/ Time: 10:54:59

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71409068-00757-0

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 372/2019 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 08.02.2019 - 10.32 |
| Komuna / Opština / Municipality: | Lipjan / Lipljan / Lipjan |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | RUBOFC / RABOVCE / RUBOVC |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | Lipjan / Lipljan / Lipjan |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-71409068-00757-0 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | | 4976 | | | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendbanimi - adresa<br>Prebivaliste - adresa<br>Resident - address | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address Details | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| DRUM/DRUM/DRUM | | DRUM | | |

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Tokë Tjetër/Ostalo Zemljiste/OtherLand | Jo Pjellore/Neplodno/Unproductive | | 4976 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor | **P.SH. E KUVENDIT KOMUNAL LIPJAN** | KCID1411956 | RUBOVCË / RUBOVCË / RUBOVCË / | | LIPLJAN | 1/1 | | |

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : LIPJAN

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Rubofc

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m2 |
|---|---|---|
| P-71409068-00757-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 4976,0 |
| | | |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:879

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 08.02.2019

Koha/ Vreme/ Time: 10:31:19

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

**Harta kadastrale e Kosovës** - Shfaqësi i gjendjes së tanishme | Përdoruesi: Izjah Shala

1 : 1000

Auto




KosovaRef01


Varrezat aktuale
Va


Propozimi për varreza